

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6930  
E shtunë, 24 qershor 2023  
Çmimi 0.40

NATO-ja përfundon  
stërvitjet historike ajrore  
në Evropë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, TË PREMTEN NË NJË KONFERENCË PËR  
MEDIE SËRISH KA FOLUR PËR ZHVILLIMET NË KOSOVË | FAQE 3

## RAMA UA NIS LETRËN E DYTË MACRONIT DHE SCHOLZIT: KY RAJON NUK ËSHTË AS I KURTIT AS I VUÇIQIT



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije të premten se sërish ua ka nisur një letër të dytë presidentit të Francës, Emmanuel Macron, kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe presidentit të

Këshillit Evropian, Charles Michel, nga të cilët ka kërkuar që plani franko-gjerman në raport me Kosovën dhe Serbinë "të zbatohet me përpikëri". Rama ka thënë se një shtysë e re, konkrete, nga Franca e

Gjermania, me mbështetjen e ShBA-së për finalizimin e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, është sot një domosdoshmëri po aq alarmante sa situata në degradim të vazhdueshëm në veriun e Kosovës

### AKTUALE



BE-ja MIRATON PAKON E 11-TË TË  
SANKSIONEVE NDAJ RUSISË | F. 2

EDITA TAHIRI: KURTI E DËSHTOI  
KOSOVËN NË NEGOCIATA NË  
BRUKSEL | F. 5

SVEÇLA: BANDAT KRIMINALE NË  
VERI NDËR VITE KANË USHTRUAR  
TERROR MBI QYTETARËT TANË | F. 7

### EKONOMI



PSD-ja: 12 PUNËTORË KANË  
VDEKUR NË PUNË NË 6 MUAJT E  
FUNDIT | F. 8

KMDLNJ: NDËRTIMTARIA,  
RREZIKUESJA MË E MADHE E  
JETËS SË PUNËTORËVE | F. 8

NUK KA  
ZGJIDHJE TË  
PROBLEMIT NË  
VERI, DIALOGU  
NGECËN | FAQE 4-5



THAÇI DHE TË  
TJERËT, RRËZOHEN  
KËRKESAT E DISA  
PERSONAVE QË  
PRETENDOJNË SE  
JANË VIKTIMA | FAQE 3



### SPORT



MALISHEVA NËNSHKRUAN ME  
FETAHAJN, PËRFORCOHEN EDHE  
PRISHTINA, DRITA DHE LIRIA | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja miraton pakon e 11-të të sanksioneve ndaj Rusisë

**BRUKSEL, 23 QERSHOR** - Këshilli i Bashkimit Evropian e ka miratuar pakon e 11-të të sanksioneve kundër Rusisë për pushtimin e paprovokuar të Ukrainës. Në këtë pako zgjerohen disa kufizime të mëhershme dhe shtohen dhjetëra entitete të reja në listën e sanksioneve. Përmes kësaj pakoje Bashkimi Evropian po tenton t'ua pamundësojë vendeve dhe kompanive të tjera t'i anashkalojnë masat e vendosura më parë.

Këshilli i publikoi sanksionet pas miratimit të tyre më 23 qershor, duke thënë se pakoja do të sigurojë që sanksionet e BE-së kundër Rusisë "të zbatohen edhe më mirë, bazuar në mësimet e nxjerra nga zbatimi i tyre gjatë vitit të kaluar".

Sanksionet e fundit synojnë t'i mbyllin zbrazetirat në atë

mënyrë që mallrat dhe teknologjia kyçe për përpjekjet luftarake të Rusisë të mos arrijnë në Rusi nëpërmjet vendeve që tregtojnë me BE-në.

Këshilli i BE-së tha se ka shtuar 87 entitete të reja në listën e sanksioneve, për të cilat BE-ja thotë se "po e mbështetin drejtpërdrejt kompleksin ushtarak dhe industrial të Rusisë në luftën e saj kundër Ukrainës". Këto kompani, tha blloku evropian, janë të regjistruara në Kinë, Uzbekistan, Emiratet e Bashkuara Arabe, Siri dhe Armeni. "Sisteme janë duke u vendosur në disa vende për monitorimin, kontrollin dhe bllokimin e rieksporit", thuhet në deklaratën e BE-së. "Shifrat anormale të tregtisë për disa produkte/vende shumë specifike janë dëshmi e fortë se Rusia po përpiket në mënyrë



aktive t'i anashkalojë sanksionet. Kjo kërkon që ne t'i dyfishojmë përpjekjet tona për trajtimin e anashkalimit dhe t'u kërkojmë fqinjëve tanë

bashkëpunim edhe më të ngushtë".

Pakoja e re lejon zbatimin e masave që kufizojnë eksportin e mallrave dhe teknologjisë drejt

vendeve të treta, të cilat më pas mund t'i transferojnë ato në Rusi. Rregullat e reja ia lejojnë BE-së të ushtrojë shumë më tepër presion për t'i dhënë fund praktikës së mëparshme.

Zyrtarët e BE-së kanë qenë prej kohësh të shqetësuar për një rritje të kërkesës për produktet e BE-së nga fqinjët e Rusisë, të cilët kanë vazhduar marrëdhënie tregtare me Moskën.

Pakoja, gjithashtu, përfshin pezullimin e licencave të transmetimit të BE-së për pesë media të tjera shtetërore ruse të kontrolluara, duke e çuar numrin total të medieve në dhjetë.

Për më tepër, pakoja ndalon hyrjen në portet e BE-së për anijet që angazhohen për transferimin e naftës së papërpunuar ose të produkteve të naftës në det, nëse ka arsye për të dyshuar se ngarkesa ka origjinë ruse.

## Qindra emigrantë shpëtohen në Ishujt Kanarie



**MADRID, 23 QERSHOR** - Zyrtarët spanjollë kanë bërë me dije se të paktën 227 emigrantë u shpëtuan pranë ishujve Kanarie të Spanjës një ditë pasi u raportua për vdekjen e më shumë se 30 emigrantëve në këtë zonë.

Shërbimet e urgjencës thanë se emigrantët po udhëtonin me gomone pranë ishujve Lanzarote dhe Gran Kanaria në Atlantik. Një numër prej tyre u dërguan në spital për t'u trajtuar për lëndime joserioze.

Më 22 qershor dy organizata bamirëse thanë se më shumë se 30 emigrantë mund të jenë mbytur pasi gomonia e tyre u fundos në Gran Kanaria.

Autoritetet spanjolle thanë se ekipet e shpëtimit i gjetën trupat e një të mituri dhe një burri, si dhe shpëtuan edhe 24 persona të tjerë.

Megjithatë, organizatat bamirëse Walking Borders dhe Alarm Phone thanë se rreth 60 njerëz kishin qenë në gomonet e fundosura.

Helena Maleno Garzon, nga Walking Borders, tha se 39 persona ishin fundosur, përfshirë katër gra dhe një foshnje. Ndërsa Alarm Phone tha se 35 persona ishin të zhdukur. Të dyja këto organizata monitorojnë barkat me të cilat udhëtojnë emigrantët dhe komunikojnë me pasagjerët e tyre apo të afërmit e tyre.

## Në anijen e fundosur në Greqi ishin të paktën 350 pakistanezë

**ATHINË, 23 QERSHOR** - Ministri i Brendshëm i Pakistanit, Rana Sanaulah Khan, më 23 qershor ka njoftuar se rreth 350 pakistanezë ishin në bordin e anijes për peshkim, e stërmbytur me emigrantë, e cila u fundos në Greqi më 14 qershor.

Ministri Khan tha se shumë prej tyre janë të zhdukur dhe mund të kenë vdekur në një nga incidentet më vdekjeprurëse në Detin Mesdhe.

Khan u tha deputetëve në Parlament se rreth 700 emigrantë ishin në anije kur ajo u fundos më 14 qershor.

Vetëm 104 persona, përfshirë 12 pakistanezë, u shpëtuan dhe 82 trupa u nxorën.

Khan theksoi drojën se shumë nga pakistanezët e zhdukur kanë vdekur. "Deri më tani 281 familje kanë kontaktuar me qeverinë duke thënë se djemtë ose të dashurit e tyre mund të kenë qenë në mesin e atyre që ishin në anije", tha ai.

Aktualisht zyrtarët po mbledhin mostra të ADN-së nga njerëzit që thonë se anëtarët e familjes së tyre ishin në anije për të ndihmuar në identifikimin e trupave.

Gjithashtu, qeveria nisi aksionin kundër trafikantëve të qenieve njerëzore që organizuan udhëtimin për pakistanezët, me një anije peshkimi, shumë prej të cilëve kërkonin punë në Evropë.

Policia deri më tani ka arrestuar së paku 17 të dyshuar në lidhje me

këtë rast.

Zyrtarët thonë se viktimat u paguanin kontrabandistëve nga 5 000 deri në 8 000 dollarë për udhëtimin.

Shumë nga pakistanezët e zhdukur janë nga provinca lindore më e populluar e Punjabit dhe qytetet e largëta në Kashmir, nga rajoni i kontestuar në Himalaje, i ndarë midis Pakistanit dhe Indisë.

Pakistanit po përjeton një nga krizat e tij më të rënda ekonomike, me inflacion deri në 45 për qind në muajt e fundit, ndërkaq shumë të rinj kanë rrezikuar rrugën e tyre drejt Evropës për të gjetur punë më të mira.



KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, TË PREMTEN NË NJË KONFERENCË PËR  
MEDIE SËRISH KA FOLUR PËR ZHVILLIMET NË KOSOVË

# Rama ua nis letrën e dytë Macronit dhe Scholzit: Ky rajon nuk është as i Kurtit as i Vuçiqit

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije të premtent se sërish ua ka nisur një letër të dytë presidentit të Francës, Emmanuel Macron, kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, nga të cilët ka kërkuar që plani franko-gjerman në raport me Kosovën dhe Serbinë “të zbatohet me përpikëri”. Rama ka thënë se një shtysë e re, konkrete, nga Franca e Gjermania, me mbështetjen e ShBA-së për finalizimin e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, është sot një domosdoshmëri po aq alarmante sa situata në degradim të vazhdueshëm në veriun e Kosovës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**TIRANË, 23 QERSHOR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se një shtysë e re, konkrete, nga Franca e Gjermania, me mbështetjen e ShBA-së për finalizimin e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, është sot një domosdoshmëri po aq alarmante sa situata në degradim të vazhdueshëm në veriun e Kosovës.

Në një konferencë për medie, Rama ka thënë të premtent se nuk ka asnjë problem personal me Albin Kurtin, por pas komenteve të fundit kur ai refuzoi draft-marrëveshjen me argumentin “le t’ia paraqesë Beogradit”, gjërat mes vendeve nuk janë ashtu siç duhet. Sipas Ramës, nëse Shqipëria konsiderohet si “vëllai i madh” i

Kosovës, detyrimi i saj është që gjërat t’i thotë hapur ashtu siç janë. Dhe e vërteta, sipas Ramës, është që gjërat për Kosovën në raportet e saj me ndërkombëtarët janë shumë keq. “Për mua është shumë e qartë ajo që ka ndodhur. Albini nuk e ka dashur konfrontimin e drejtpërdrejtë për këtë temë sepse Albini lexon sondazhet dhe kënaqet se i rriten poenët. Mirëpo, Shqipëria nuk është notere dhe nuk mund të jetë kurrë notere e një politike që ndjek Kosova. Aq më tepër kur Shqipëria konsiderohet si ‘vëllai i madh’ i Kosovës, sikurse thoni ju, jo unë, sepse unë nuk e kam thënë kurrë një gjë të tillë. Detyrimi ynë është ta themi të vërtetën në sy dhe ta mbajmë qëndrimin tonë. Shqipëria është shtet me vete që ka interesat e saj. Marrëveshjet që ishin gati për t’u firmosur mund të firmoseshin po



njësoj pa pasur nevojë për të dhënë një shfaqje sikur gjërat janë normale. Gjërat nuk janë normale. Janë keq dhe unë po bëj gjithçka për ta shmangur më të keqen. Në emër të qeverisë shqiptare po bëjmë sa po mundemi. Por të vijë dita që të diskutohet lojaliteti i partnerëve me Kosovën është shumë keq”, ka thënë Rama. Ai ka shtuar se i duket e tmerrshme që programe të caktuara të bashkëpunimit të BE-së me Kosovën janë ngrirë. “Unë nuk hy tek ata që i konsiderojnë ndërkombëtarët dhe partnerët si Zoti vetë. Zoti është mbi ne dhe

mbi ndërkombëtarët. Është mbi Amerikën dhe Shqipërinë, por në këtë rast është katastrofë që të këputen në këtë farë feje lidhjet me bashkësinë euroatlantike. Kështu që unë jam i gatshëm të takohem me Albinin në çdo moment. Në nivelin personal nuk kam asnjë problem që të takohem me Albin Kurtin, madje po të na shihni bashkë ju do të thoni sa mirë shkojnë. Por në nivelin konceptual gjërat nuk janë aspak mirë”, ka thënë Rama.

Rama bëri thirrje për lirim pa kushte të tre zyrtarë policorë të Kosovës që janë arrestuar nga Serbia. Ai e cilësoi mbajtjen e tyre në paraburgim si “mbajtje peng” dhe e kritikoi qëndrimin që ka mbajtur Serbia. “Mbajtja e tyre në burg është e pajustificueshme dhe përpjekja për ta mbuluar këtë lajthitje shtetërore (të Serbisë) për mbajtjen e tre policëve të huaj, duke ngritur zërin për arrestimin e disa shtetasve serbë nga Policia e Kosovës, është tejet shqetësuese”, ka thënë Rama.

Kryeministri Rama ka bërë me dije se u është drejtuar sërish me një letër të dytë presidentit të Francës, Emmanuel Macron, kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, duke kërkuar që plani franko-gjerman “të zbatohet me përpikëri”. Ai ka shtuar se,

përndryshe, ekziston rreziku i “një përplasje të armatosur mes grupeve që operojnë në veriun e Kosovës dhe forcave të sigurisë”, gjë që tha se është vetëm në interes të Rusisë. “I kam nisur një nisur një letër të dytë presidentit Macron, kancelarit Scholz dhe Charles Michel, për një domosdoshmëri që Franca dhe Gjermania, në mbështetje të ShBA-së, që plani franko-gjerman të zbatohet me përpikëri”, ka theksuar Rama.

Sipas kryeministrit Rama, interesi i tyre kombëtar kërcënohet nga kjo situatë. “Është shumë e rëndësishme ta kuptojnë të tërë, që nga ata që flasin për vëllezër të vegjël e të mëdhenj tek ata që kërkojnë arsye të mosarsyes për ta shtyrë zvanë këtë proces. Interesi ynë kombëtar kërcënohet nga kjo situatë. Ky rajon nuk është as i Albinin, as i Aleksandrit. Është i vendeve që e përbëjnë. Ky rajon ka vuajtur boll nga përplasjet e vazhdueshme”, është shprehur Rama, duke shtuar se këto tensione favorizojnë vetëm presidentin rus. “I vetmi që përfiton është ai që rri në bunkerin e tij në Kremlin. Nëse do të bëhet një imazh, me siguri Rusia do të ishte me një fytyrë të ngërdheshur”, ka thënë Rama.

Propozimi evropian, i njohur fillimisht si plani franko-gjerman, synon të çojë në normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.



## Konjufca: Shqipëria dhe Kosova, krah njëra-tjetrës në procesin e integritimit

**PRISHTINË, 23 QERSHOR** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë në konferencën e përbashkët shkencore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me temën “Harmonizimi i legjislacionit mes Kosovës dhe Shqipërisë në procesin e integritimit evropian”. Në fjalën e tij, Konjufca

theksoi se ky takim, në vazhden e aktiviteteve të përbashkëta, thëllon bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, me theks të veçantë në fushën e harmonizimit të legjislacionit mes dy vendeve tona, në kuadër të procesit të integritimit evropian. “Shqipëria dhe Kosova, si dy shtete aspirante për integritim në Bashkimin Evropian, para së gjithash si dy shtete që

përfaqësojnë ëndrrën e të njëjtit komb, duhet të jenë në krah të njëra-tjetrës në procesin e gjatë e të vështirë të integritimit në BE”, ka deklaruar Konjufca. Kreu i Kuvendit shtoi se në këtë proces Shqipëria si shtet me përvojë të avancuar në sferën e integritimit evropian mund ta ndihmojë shtetin e Kosovës për kapërcimin e pengesave të cilat ajo i ka tejkaluar.





# Nuk ka zgjidhje të problemit në veri, dialogu ngecën

Shefi i politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se pas takimeve të fundit të ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është arritur pajtimi për nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Ai ka thënë se pas më shumë se katër orë diskutimesh, të dy udhëheqësit e kanë të qartë seriozitetin e situatës në veri, por kanë qasje dhe interpretime të ndryshme për situatën

**EPOKA ERE**

**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Shefi i politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimeve të ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, ka thënë se është arritur pajtimi për nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Ai ka treguar se pas më shumë se katër orë diskutimesh të dy udhëheqësit e kanë të qartë seriozitetin e situatës në veri, por kanë qasje dhe interpretime të ndryshme për situatën.

Borrelli ka thënë se së bashku me të dërguarin evropian për bisedimet Kosovë - Serbi,

Miroslav Lajçak ua paraqiti palëve pritjet e Bashkimit Evropian. "Për Kosovën që menjëherë të pezullojë operacionet policore në ndërtesat e komunave në veri dhe që katër kryetarët e komunave përkohësisht t'i kryejnë detyrat jashtë zyrave komunale. Serbia të sigurojë që protestuesit të largohen nga ndërtesat e komunave njëkohësisht me largimin e policisë së Kosovës", ka deklaruar Borrelli.

Të dyja palët, tha ai, duhet të shpallin zgjedhjet e reja në të katër komunat, me pjesëmarrje të pakusht të serbëve në to. "Kjo është rrënja e problemit dhe rrënja e zgjidhjes - zgjedhje të reja sa më parë me pjesëmarrje të plotë", ka theksuar ai, duke nënvizuar se është arritur pajtimi për nevojën e mbajtjes

së zgjedhjeve.

Borrelli ka pohuar se i ka kërkuar presidentit serb lirim të menjëhershëm dhe pa kushte të tre policëve të Kosovës, një kërkesë e shtruar me forcë edhe nga Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane që kërkojnë hedhjen e hapave për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, kur për gati një muaj grupe qytetarësh serbë po protestojnë duke kundërshtuar vendosjen në zyra komunale të kryetarëve shqiptarë të dalë nga zgjedhjet e 23 prillit, që u bojkotuan nga partitë politike serbe.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas takimit në Bruksel, ka shprehur gatishmërinë për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme lokale në Kosovë, por "në përputhje me kornizën ligjore të vendit". "E kuptojmë

se ka nevojë për zgjedhje të parakohshme në katër komunat në veri, me një proces i cili paraprihet nga sundimi i ligjit, nga një fushatë e hapur dhe fer dhe nga zgjedhjet e lira dhe demokratike. Nuk mund të them se situata është e sigurt për shkak të takimeve bilaterale dhe kemi një paqe të qëndrueshme, por nga optimizmi i ndërmjetësit mund të them se ka shenja se ditët përpara do të jenë më të mira nga ato që kemi lënë pas", ka deklaruar Kurti.

Kurti këmbënguli se ishte i gatshëm të takohej me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, por ai kishte refuzuar. "Kam ardhur të takohem me palën serbe për të diskutuar për hapat përpara, por meqë ky është një proces që përfshin dy palë, kjo nuk ishte e mundur", ka shtuar Kurti, duke theksuar se është i gatshëm të jetë në bisedime derisa të gjendet një zgjidhje.

Pas takimit me ndërmjetësuesit e dialogut, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se nuk mund të konfirmojë që "ka ndonjë udhërrëfyes" për daljen nga kriza në veri të Kosovës. "Kemi diskutuar çështjen,

substancën, e cila ishte e pashmangshme, por besoj edhe e dobishme, por atë që do të shohim nesër në terren, nuk e di... kur kemi kamionë në pritje...", ka thënë ai, duke iu referuar bllokimit të qarkullimit të kamionëve me mallra serbe në kufi me Kosovën.

Lidhur me zgjidhjen e situatës në Kosovë, Vuçiqi ka thënë se ka frikë se "çdo gjë ka shkuar shumë larg". "Ne do të vazhdojmë të bisedojmë çdo ditë, sepse paqja dhe stabiliteti janë kyçe, por unë paralajmërova se serbët janë në një pozitë shumë të vështirë dhe se nuk duan ta durojnë terrorin e Kurtit në atë mënyrë që janë detyruar ta detyrojnë deri në këtë moment", ka thënë Vuçiqi.

Që nga fundi i majit tensionet në veri të Kosovës u rritën pasi kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, me asistimin e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale, mes kundërshtimeve nga serbët lokalë. Që atëherë serbët lokalë kanë protestuar para ndërtesave komunale në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Më 14 qershor tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë u përkeqësuan edhe më tej, pas

# Edita Tahiri: Kurti e dështoi Kosovën në negociata në Bruksel

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka folur për situatën e fundit në veri. Ajo ka thënë se kryeministri Albin Kurti me zgjedhjet në veri shkeli kushtin që zgjedhjet të ishin teknike dhe jo politike. Tahiri në një intervistë në "Top Story" për "Top Channel" ka treguar se ku gaboi Albin Kurti për situatën në veri, që detyroi ndërkombëtarët t'i dilnin kundër. Ajo ka thënë se zgjedhjet e mbajtura në komunat e Kosovës, pavarësisht se morën aprovimin nga ndërkombëtarët, Kurti shkeli kushtin që zgjedhjet të ishin teknike dhe jo politike. "Kosova e plotë pa veriun nuk ka asnjë interes, fuqia e Kosovës është te veriu. Janë dy arsye strategjike që nuk kam mundësi t'jua them. Janë disa kontekste gjeostrategjike që nuk lidhen as me Kosovën, as me Serbinë, as me Ballkanin. Janë përtej. Lojën e Albinit për ta ruajtur agjendën populiste në veri, Vuçiqi e përdori në mënyrë djallëzore, tërhoqi minoritetin serb nga institucionet e Serbisë. Në veri nuk ka pasur pika kufitare. Unë

e arrita marrëveshjen me të cilën u vunë kufijtë. Amerika dhe BE-ja i dhanë përkrahje se ishin legale, por ato dolën jolegitime, shpesh analistët thonë pse kur amerikanët i përkrahën zgjedhjet, çfarë ndodhi. Amerikanët thanë le të hyjnë kryetarët e zgjedhur edhe në ato kushte, por në mënyrë teknike, jo politike. Të vazhdonin punën pa manifestim politik, kjo ishte shkelja e parë që ua bëri Albini amerikanëve. Në vend se të thotë kërkoj falje që hyrjen teknike e bëra politike, ai i fsheh gjërat. Kjo i nervozoi amerikanët dhe për herë të parë ndodhin ndëshkimet. Më 1992 Kosova vulosi aleancën me Amerikën, kur Bush doli me politikën e kërcënimit ndaj Millosheviqit. Po të mos ishte përkrahja e tyre nuk do të vinim në këtë ditë", ka thënë ish-kryeministrja e Kosovës. Tahiri ka thënë se Albin Kurti gabon me gjuhën e ashpër ndaj palës së tretë negociatore në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nga aspekti negociator një shtet si palë nëse ankohet te pala e tretë se po e përkrah palën tjetër është dobësi. Shteti

duhet të ketë aftësi të punojë me palën e tretë, janë mënyra diplomatike kur ka vërejtje. Kjo tregon vogëlsinë e shtetit, s'ka aftësi ta mbrojë dinjitetin e shtetit. Kur je palë duhet të kesh integritet, jo kërkesa si fëmijë. Nëse ndërmjetësuesit e mbështetin Serbinë, kanë interesat e tyre. Aftësia duhet të jetë t'i kthesh interesat e shtetit tënd", është shprehur Edita Tahiri. Ajo ka thënë se Kurti e dështoi Kosovën në këto negociata në Bruksel. "Arriti marrëveshjen bazë me planin franko-gjerman pa njohje reciproke. Bideni thoshte se ky dialog duhet të fokusohet në njohjen reciproke, Albini e humbi rastin për këtë periudhë. Ai ka qenë i kufizuar mes populizmit të tij dhe mungesës së zotësisë si burrështetas. Sepse ti kur negocion me armikun, numër një ke shtetin pastaj pushtetin. Ai thoshte nuk shkoj kurrë në dialog pa kërkuar falje Serbia për gjenocidin. Të gjitha i harroi rrugës e shkoi në dialog pa falje dhe pranoi asociacionin", është shprehur Tahiri. Ajo ka thënë se kemi të bëjmë me një kryeministër i cili

praktikisht shfrytëzoi populizmin, mori simpatinë dhe nuk i mbajti premtimet. "Ai duhej ta rivlerësonte ecjen e punës. Ai nuk ka as përvojë në negociata, por as njohuri në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kemi të bëjmë me një kryeministër që nuk ishte gati të qeveriste e as për dialog. Në këto gjëra duhet të kesh kredibilitet. Tensionet në veri nuk janë serioze. Janë krijuar nga nevoja e Kurtit", ka thënë Tahiri. Edita Tahiri e ka komentuar propozimin e Ramës për draft-asociacionin si të anshëm pasi, sipas saj, ai mbështet Serbinë. Tahiri u shpreh se Rama ia ka humbur kredibilitetin Shqipërisë në Kosovë me gjithë afrimitetin që ka krijuar me Vuçiqin. "Shqipëria vuajti nga regjimi totalitar e ne vuajtëm nga armiku serb. UÇK-ja erdhi në një kohë shumë të rëndësishme e shumë strategjike, se mënyra paqësore nuk kishte më produkt. Në '97-n ishte ende kohë e rëndë. Në vitin '99 e ngritëm çështjen e Kosovës në nivelin më të lartë në konferencën e Rambujesë. Shtetet e mëdha u bashkuan

bënë negociatat e morën vendim që NATO të ndërhynte pavarësisht se OKB-ja nuk e autorizoi. Kurti në atë kohë ishte asistent te zyra e Adem Demaçit. Duhet parë ideologjia e tij politike dhe ndërkombëtare. Këtë vit erdhi një lider i Kosovës që u ndëshkua nga amerikanët bashkë me Kosovën. Nëse nesër bëhen zgjedhjet siç tha Borrell i takon Kurtit t'i përgatisë mirë e legjitime. Në praktikën e negociatave, praktikohet që ndonjë palë e tretë dëshiron të japë shërbime të mira, por në ato raste pala e tretë duhet të jetë e paanshme, në rastin e Ramës mendoj se ka menduar në bazën e kësaj linje ta ndihmojë procesin. Në këtë situatë Rama është i anshëm, i afërt me Serbinë dhe me Vuçiqin. Në Kosovë Rama nuk ka kredibilitet, sepse ka hyrë në lojën e ndarjes së veriut, pra është me Vuçiqin. U bë pjesë e Ballkanit të Hapur. Pra Rama në Kosovë ia ka humbur Shqipërisë kredibilitetin, ka bërë dështime historike. Unë thashë Albini është i padijshëm, nuk ka zotësi e njohuri. Nuk thashë nuk është konstruktiv", ka deklaruar Rama.



→ arrestimit të tre zyrtarëve policorë të Kosovës. Serbia tha se ata u arrestuan "thellë" brenda territorit të saj, por Kosova tha se ata ishin duke patrulluar në territorin e

Kosovës, pranë vijës kufitare me Serbinë në Leposaviq. BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara i kanë paraqitur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, tri kërkesa sa iu përket

tensioneve: qetësimin e situatës në veri të Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri dhe rikthimin në dialogun për normalizimin e raporteve.

ShBA-ja, po ashtu, e ka inkurajuar Kurtin që kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri t'i kryejnë detyrat e tyre nga lokacionet alternative. Kurti, ndërkaq, ka paraqitur

një plan prej pesë pikash. Plani i Kurtit parasheh edhe mbajtjen e zgjedhjeve. Megjithatë, ai ka thënë se për t'u mbajtur zgjedhje të lira në veri nevojitet shtet ligjor.

## Totaj rikonfirmon mbështetje për komunitetin egjiptian

PRIZREN, 23 QERSHOR - Në vigjilje të festës së 24 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të premtën një

delegacion të prirë nga kryetari i Partisë Liberale të Egjiptianëve, Veton Berisha, me ç'rast rikonfirmoi mbështetjen e komunitetit egjiptian me të gjitha mënyrat që ka në dispozicion komuna

e Prizrenit. Totaj ka thënë se kjo ditë synon promovimin e trashëgimisë, traditës dhe kulturës së egjiptianëve për krijimin e klimës adekuate për qasje në arsimim, punësim dhe shërbime të tjera publike.



## Filloi procesi i zgjedhjeve të Këshillave Lokale në komunën e Malishevës

MALISHEVË, 23 QERSHOR - Ka filluar organizimi i Këshillave Lokale në territorin e komunës së Malishevës, bazuar në rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Të enjten janë mbajtur zgjedhjet në Këshillin Lokal të fshatrave Astrazup dhe Burim, ku janë zgjedhur kryesia, kryetari dhe nënkryetari i këtij këshilli. Zgjedhja apo formimi i Këshillave Lokal organizohet nga komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, bazuar në rregulloren komunale që e rregullon formimin e këshillave

lokale.

Ky komision përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, sipas përfaqësimit politik në kuvend, një anëtar nga zyra e kryetarit të komunës dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Kuvendi i Këshillit Lokal për Astrazup dhe Burim, ku ishin të pranishëm 102 anëtarë të Kuvendit, e kanë zgjedhur kryesinë e këshillit të tyre, që përbëhet nga nëntë anëtarë, ku gjashtë anëtarë janë nga fshati Astrazup dhe tre nga fshati Burim, ndërsa kryesia e ka zgjedhur për kryetar të këshillit Nuredin Morinën (Astrazup) dhe nënkryetar Gëzim Krasniqin (Burim).



## Për herë të parë qytetarët e Gjilanit vendosën se ku duan t'i investojnë mjetet e ndara nga komuna

GJILAN, 23 QERSHOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se për herë të parë qytetarët vendosën se ku duan t'i investojnë mjetet e ndara nga komuna. Ai ka theksuar se

bashkërisht do të ndërtojmë një qytet më të mirë për të gjithë. "Me transparencë të plotë e gjithëpërfshirje organizuam dëgjime buxhetore me gratë, të rinjtë dhe banorët e fshatit

Zhegër, Miresh e Bresalc, ku banorët vetëpropozuan dhe më pas votuan projektet prioritare për komunitetin dhe lokalitetet e tyre", është shprehur kreu i komunës së Gjilanit.

## Përfundon renovimi i hapësirës rekreative-sportive në Kamenicë

KAMENICË, 23 QERSHOR - Forumi i Komunitetit për Interes Publik (CFPI) në bashkëpunim me komunën e Kamenicës ka rinovuar fushën sportive të Parkut të Qytetit të Kamenicës, pasi kjo hapësirë është vlerësuar si një nga hapësirat më të rëndësishme për interes publik, veçanërisht për rininë multietnike të Kamenicës. Në këtë fushë, puna në terren u

përfundua me sukses dhe u realizua renovimi i kësaj hapësire rekreative-sportive, e cila tani është gati për përdorim nga të gjithë komunitetet në komunën e Kamenicës.

Projekti "Nxitja e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik (FIERC)" financohet nga Fondi i Paktit të Stabilitetit të Ministrisë së Jashtme Federale Gjermane German Embassy Pristina.



## Mbi 100 mijë qytetarë presin epilogun e padive të tyre civile

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Duhet mesatarisht pesë vjet e tre muaj pritje për trajtimin e një padie civile nga gjykatat e

Kosovës. Ngërçit të drejtësisë civile i kanë kontribuar veçanërisht paditë nga punonjësit e arsimit dhe

shëndetësisë lidhur me kontratat kolektive, por edhe mosefikasiteti dhe numri i vogël i gjyqtarëve në raport me

lëndët, ka raportuar REL. Aktualisht janë 90 gjyqtarë të cilët trajtojnë lëndë të natyrës civile.



## Thaçi dhe të tjerët, rrëzohen kërkesat e disa personave që pretendojnë se janë viktimat

HAGË, 23 QERSHOR - Paneli i Gjykatës së Apelit ka rrëzuar apelet e parashtruara nga dy grupe individësh kundër vendimit të Trupit Gjyqësor me të cilin u refuzuan kërkesat e tyre për të marrë pjesë si viktimat në çështjen Thaçi dhe të tjerët.

Trupi gjyqësor ka konstatuar se krimet që personat pretendojnë se i kanë vuajtur, nuk përfshihen në kuadrin gjeografik apo material të aktakuzës.

Gjithashtu, Paneli i Apelit ka konstatuar se mbrojtësi i

viktimave të refuzuara nuk e ka vërtetuar se trupi gjyqësor kishte bërë konstatim të gabuar kur nuk e kishte pranuar kërkesën, andaj edhe e ka rrëzuar mocionin.

Gjykimi ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) do të vazhdojë të hënën e 10 korrikut me dëgjimin e dëshmitarit të prokurorisë.

Më 20 qershor, në Gjykatoren e Speciales, ka përfunduar dëgjimi i dëshmitarit të njëmbëdhjetë, seancë kjo e cila u pasua nga një konferencë mbi ecurinë e çështjes.

Aty trupi gjyqësor ka theksuar edhe njëherë shqetësimin lidhur me ritmin e këtij procesi gjyqësor. Kryegjykatësi Charles Smith ka kërkuar seanca sa më shumë publike.

Gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka nisur më 3 prill me deklaratat hyrëse të palëve.

Para trupit gjyqësor ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat për krime të pretenduara të luftës. Ata ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. /Ksp



## NATO-ja përfundon stërvitjet historike ajrore në Evropë



PRISHTINË, 23 QERSHOR - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (KFOR) i përfundoi më 23 qershor stërvitjet më të mëdha ndonjëherë të dislokimit të forcave ajrore në Evropë, në atë që po cilësohet si një shfaqje e fuqisë kundër kërcënimeve të mundshme nga Rusia.

Manovrat "Air Defender 23", të udhëhequra nga Gjermania, mbledhën rreth 250 avionë ushtarakë nga 25 vende të NATO-s, si dhe aleatë të tjera, përfshirë Japoninë dhe Suedinë. Kjo e fundit tashmë ka kërkuar anëtarësimin në aleancën ushtarake.

Rreth 10 000 pjesëtarë të shërbimit ushtarak morën pjesë në stërvitjet që synonin ta rritnin ndërveprimin dhe gatishmërinë për t'u mbrojtur nga dronët dhe raketat lundruese në rast të një sulmi brenda territorit të NATO-s.

"Ne donim të tregojmë se këto 25 kombe të ndryshme mund të veprojnë së bashku që nga

dita e parë dhe ne ia dolëm", tha kreu i forcave ajrore gjermane, Ingo Gerhartz, në transmetuesin NTV.

Stërvitja ishte një "sukses i plotë" në nivelet taktike dhe organizative, tha Gerhartz nga baza ajrore Jagel në Gjermaninë veriore.

Nga 2 000 fluturime të planifikuara, rreth 1 800 u ekzekutuan, tha Gerhartz, i cili e quajti këtë shkallë "rekorde" të ekzekutimit për këtë lloj ushtrimi. "Air Defender" u konceptua në vitin 2018 pjesërisht në përgjigje ndaj aneksimit rus të Krimesë nga Ukraina katër vjet më parë, megjithëse Gerhartz më parë kishte këmbëngulur se këto stërvitje nuk "kishin askënd në shënjestër".

Në anë tjetër, ambasadorja e ShBA-së në Gjermani, Amy Gutmann, tha se stërvitja do të tregonte "përtej çdo dyshimi shkathtësinë dhe shpejtësinë e forcës sonë aleate" dhe kishte për qëllim

të dërgonte një mesazh për disa vende, përfshirë Rusinë. "Do të isha shumë e befusuar nëse ndonjë lider botëror nuk do ta merrte parasysh atë që tregon kjo për sa i përket frymës së kësaj aleance, që do të thotë forcën e kësaj aleance, dhe kjo përfshin zotën Putin", u tha ajo gazetarëve, duke iu referuar presidentit të Rusisë, Vladimir Putin.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka shtuar aktivitetet e aleancës ushtarake perëndimore, të krijuar pothuajse 75 vjet më parë për t'u përballur me Bashkimin Sovjetik.

Finlanda dhe Suedia, të cilat për një kohë të gjatë mbajtën një qëndrim zyrtar neutraliteti për të shmangur ndonjë konflikt me Moskën, kanë kërkuar anëtarësim në NATO pas pushtimit të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Finlanda u anëtarësua në prill, por kërkesa e Suedisë është shtyrë kryesisht për shkak të kundërshtimeve turke.

## Sveçla: Bandat kriminale në veri ndër vite kanë ushtruar terror mbi qytetarët tanë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se bandat kriminale në veri të vendit ndër vite kanë ushtruar terror mbi qytetarët tanë përmes akteve të tyre të ndryshme kriminale. Ai ka thënë se të enjten, 15 deri në 20 persona kanë rrahur dy të rinj shqiptarë. Ky akt, sipas Sveçlës, është i papranueshëm dhe organet tona janë të angazhuara që sulmuesit të sillen sa më parë para drejtësisë. "Qytetarët tanë, veçanërisht ata shqiptarë, janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, ata që kanë qëndruar janë rrahur, maltretuar e terrorizuar në

vazhdimësi nga këto grupe kriminale. Shumë prej tyre janë larguar nga aty pikërisht për shkak të këtij terrori të ushtruar sistematikisht nga struktura kriminale me urdhër nga Beogradi. Akte të njëjta kanë ndodhur edhe ndaj qytetarëve të etnisë serbe të cilët kanë njohur dhe kanë bashkëpunuar me institucionet tona. Mbrëmë, 15 deri në 20 persona kanë rrahur dy të rinj shqiptarë. Ky akt, si çdo tjetër, është i papranueshëm dhe organet tona janë të angazhuara që sulmuesit të sillen sa më parë para drejtësisë", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

Në anën tjetër, ai ka theksuar se Policia e Kosovës sot ka arrestuar Nenad Orloviq, i

njohur me nofkat "Nemac" dhe "Rusi", i cili dyshohet për sulm ndaj KFOR-it në ditën e 29 majit në Zveçan ku mbeten të plagosur shumë ushtarë. "Pandëshkueshmëria dhe amnistia ndër vite e kriminelëve të tillë, ka rezultuar me sulme brutale ndaj KFOR-it nga të cilat mbi 30 pjesëtarë mbeten të lënduar. Secili që ka organizuar dhe ka qenë pjesë e atyre sulmeve do të silltet para drejtësisë. Republika nuk trembet. Secili do të japë llogari për secilin krim. Do të vazhdojmë pa u ndalur, në luftë ndaj të gjitha bandave që kanë për synim terrorin ndaj qytetarëve tanë e destabilizimin e vendit tonë", ka shkruar ministri Sveçla.



## PSD-ja: 12 punëtorë kanë vdekur në punë në 6 muajt e fundit

PRISHTINË, 23 QERSHOR - “Vetëm në 6 muajt e parë të këtij viti, 12 punëtorë e kanë humbur jetën në vendin e punës, një nga ata derisa ishte duke punuar në një projekt publik për këtë qeveri. Këto raste janë veç numra regjistrash në spitalet e shtetit”, ka thënë Partia Socialdemokrate në një aksion të realizuar të premtën para objektit të Qeverisë së Kosovës. Sipas PSD-së, punëtorët e ndërtimit punojnë dhjetëra metra mbi tokë pa siguri fizike, me paga të vogla e pa sigurim

shëndetësor. “Qeveria e Kosovës nuk e ka lëvizur gjendjen e mjerueshme që e ka gjetur as për një centimetër. Sa ishte opozitar Albin Kurti na fliste për solidaritet e organizim, sot praktikat shfrytëzuese fillojnë në zyrën e tij. Paga minimale vazhdon të jetë e njëjtë, e qeveria vazhdon ta refuzojë taksën ndaj korporatave. Barrën e inflacionit po e merr punëtori, privilegjet qeveritari e pronari. Shumë punëtorë kanë ikur jashtë, ata që kanë mbetur po

punojnë në kushte të padrejta”, është theksuar në njoftimin e këtij aksioni. PSD-ja ka theksuar se qeveria duhet me urgjencë ta adresojë nevojën për aplikimin e masave të rrepta të sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse, si dhe të garantojë pagë të dinjitetshme për çdo punëtor. “Dialogu me Serbinë, prioriteti i pari nga i shtati dikur. Në rregull. Po ku është dialogu social me sindikatat e punëtorët??”, është theksuar në njoftimin e PSD-së.



## KMDLNj: Ndërtimtaria, rrezikuesja më e madhe e jetës së punëtorëve

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar në lidhje me rrezikshmërinë e punëtorëve në ndërtimtari pasi, sipas tij, “ndërtimtaria në vend është rrezikuesja më e madhe e jetës së punëtorëve”. “Në Kosovë nuk paraqet lajm nëse ndonjë punëtor lëndohet, bëhet i paafte përjetësisht për punë apo edhe e humb jetën për faktin se punëdhënësi nuk siguron kushte për punë të punësuarit, nuk kanë kontrata pune, nuk kanë sigurime shëndetësore e mos të flasim për sigurime të jetës. Në 99 për qind të rasteve e pësojnë punëtorët, në 1 për qind të rasteve dënohen simbolikisht punëdhënësit për të vazhduar ‘vallen e vdekjes’ të atyre që për shkak të kushteve të rënda ekonomike detyrohen që të punojnë në kushte skajshmërisht të rrezikshme për jetën, pa pasur fare siguri dhe pa u kompensuar familjet për humbje të jetës”, është theksuar në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, Kosova në përgjithësi, kurse Prishtina në veçanti janë shndërruar në kantieri ndërtimi ku punohet pa orar, në ditë feste, ditë pushimi, në kushte të rënda atmosferike dhe, madje, punohet edhe gjatë natës pa pasur aspak konsideratë për sigurinë dhe qetësinë e qytetarëve. “Trafiku është



shndërruar në kaos ku kamionët e shumtë me dhe materiale inerte, cisternat me beton dhe mekanizmi ndërtues i rëndë, qarkullojnë nëpër rrugët e kryeqytetit, pa një orar të caktuar dhe pa kufizime drejtimesh kah mund të lëvizin”, është thënë në këtë reagim.

KMDLNj ka kërkuar dhe e përsërit se duhet t’u hiqet licenca e punës për punëdhënësit që nuk sigurojnë kushte për punë me ç’rast rrezikohet jeta e të punësuarve. “Gjithashtu,

KMDLNj ka kërkuar që dënimet në të holla të jenë shumë më të larta dhe nga ato mjete të grumbulluara të krijohet një Fond për ata që e pësojnë dhe familjet e tyre. Për një punëdhënësi që qarkullon dhjetëra milionë euro në fushën e ndërtimtarisë, dënimi prej 5 apo 10 000 eurosh është dënim për kafe, prandaj edhe ka përsëritje të rasteve. Është e pabesueshme që edhe pas të gjitha jetëve të humbura për shkak të kushteve të punës, askush të mos ketë përgjegjësi para ligjit. Shteti duhet të gjejë

një mënyrë që familjet që e humbin anëtarin e familjes duhet të kompensohen dhe ta kenë një pension, jo më të vogël se paga e një të punësuarit në ndërtimtari”, është theksuar në reagimin e KMDLNj.

Sipas KMDLNj-së, numri i lartë i vdekjeve dhe rasteve që kanë pësuar lëndime në vendin e punës, dhe dy rastet e kësaj jave (në Prizren dhe në Gjilan) janë dëshmi që gjendja në këtë sektor nuk është përmirësuar fare dhe është alarmi i fundit për veprim dhe

masa konkrete. “KMDLNj-ja vlerëson se, nëse nuk ndërmerren masat parandaluese për sigurimin e kushteve të mira për punë, humbja e jetëve do të vazhdojë, kurse të gjithë ne që e kemi një përgjegjësi, do të merremi me reagime gjykuese dhe me pasoja, që do të jenë shumë më të rënda nëse kemi parasysh që kantieret e ndërtimit kanë metastazuar dhe janë shtrirë pothuajse në çdo pjesë të Kosovës”, është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

## Hoti: Çfarë ka ndodhur me kushtet e jetës në Kosovë?

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka publikuar disa të dhëna të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në të cilat krahasohen kushtet e jetës në Kosovë në vitin 2020 dhe 2022. Sipas statistikave të

publikuara nga Hoti, në vitin 2022 është rritur përqindja e ekonomive familjare që s’kanë mundur t’i përballojnë pagesat, dy herë ose më shumë gjatë vitit. “2020: Rreth 12.7 për qind e ekonomive familjare kishin vështirësi të mëdha në kryerjen e pagesave

të nevojshme marrë parasysh të ardhurat totale dhe gjendjen për t’i kryer pagesat e nevojshme të zakonshme. 2022: 19 për qind e ekonomive familjare nuk kanë mundur t’i përballojnë pagesat dy herë ose më shumë gjatë vitit”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.





# Mësime mbi pushtetin nga Don Vito Corleone



Nga Miquel ECHARRI

Në një nga momentet më të paharrueshme të serialit të animuar "Family Guy", Griffins janë gati të vdesin dhe Peter, patriarku i ndjerë, vendos t'i tregojë familjes së tij sekretin e fundit: "Nuk e kam aspak qejf filmin The Godfather". Gruaja dhe fëmijët i kujtojnë se ai është një kryevepër, një poezi vizuale, "tragjedia e madhe amerikane". Nëse kjo batutë pëlqehet, kjo ndodh sepse gati të gjithëve u pëlqen filmi "The Godfather". Trilogjia e Francis Ford Coppola-s është një nga ato artefakte kulturore që gjeneron një konsensus të rrallë, një klasik shumë popullor, që është në të njëjtën kohë një ushqim për

kinematë, një hit që e ruan reputacionin e tij të paprekur edhe 5 dekada më vonë.

Alberto Mayol, sociolog, politolog dhe shkrimtar, ka vënë re se filmat dhe romani i Mario Puzzo ofrojnë një mjet për reflektim dhe mësim. Kumbari, argumenton ai, është "një leksion i vërtetë mbi pushtetin: si ta marrësh, si ta mbash, si ta forcosh dhe si dhe ta përdorësh atë".

Kjo gjë shihet tek aftësia e paanshme dhe amorale e Vito Corleone dhe djalit të tij Michael, trashëgimtar i perandorisë së tij. Mayol po promovon aktualisht botimin spanjoll të librit "50 ligjet e pushtetit tek The Goodfather (Kumbari)", një botim shumë informues mbi atë shumicë të heshtur që nuk ka reflektuar kurrë mbi natyrën e pushtetit dhe që

për rrjedhojë, është i dënuar të vuajë prej tij.

Duke parë mbrapa në kohë, autori kujton se ra në kontakt me sagën e filmit në vitin 1990, kur u transmetua në Kili pjesa e tretë: "Xhaxhai im këmbënguli që të shkonim ta shihnim bashkë në kinema, edhe pse unë isha ende i mitur. Argumenti i tij, skandaloz për një fëmijë të vogël, ishte se për ta shijuar vërtet një film të tillë, duhet fillimisht të shkelësh një ligj".

Vite më vonë, Mayol do të befasohej duke iu rikthyer herë pas here sekuencave të veçanta, duke gjetur në to "një reflektim shumë të thellë, aspak të parëndësishëm, mbi atë perëndi mitologjike që ne e quajmë pushtet, dhe që qëndron prapa pothuajse të gjitha


marrëdhënieve shoqërore, jo vetëm në politikë."

Kjo intuitë e nxitë të zhvillonte një seri seminaresh mbi "The Godfather" dhe një podcast edhe më popullor me titullin "La Cosa Nostra", që u bë shumë i njohur gjatë pandemisë. Dhe prej tyre lindi edhe ideja për librin. Në hapje të seminarit të tij, Mayol thoshte me shaka se e tija është "një metodë analitike thelbësisht e krahut të djathtë, sepse nis nga një pragmatizmi shumë i ashpër". Ai citon shembuj specifikë për të zbërthyer logjikën e paepur të Corleones dhe arrin në përfundime shumë domethënëse: "Don Vito e ushtronte gjithmonë pushtetin pa kufizime, por me një sens të mirë dhe moderim".

Studentët e tij më të mirë do të

duhej të gjendeshin në spektrin konservator, tek Winston Churchill, Giulio Andreotti dhe Angela Merkel, por edhe tek dhomat e pasme dhe të errëta të pushtetit si për shembull CIA, Vatikani apo bordet e drejtorëve të korporatave shumëkombëshe". Sipas tij e majta perëndimore nuk po gjeneron udhëheqës të mëdhenj, sepse ka ngecur në një diskurs rezistence ndaj pushtetit, që e dënon atë me një mungesë efektiviteti". E njëjta gjë mund të thuhet për pjesën më të madhe të qytetarëve të Evropës komunitare që janë "vegjetarianë në një botë mishngrënëse", disa prej tyre po aq të pangopur sa Vladimir Putini, "të cilët jo vetëm helmojnë kundërshtarët e tyre, por duan që kjo të bëhet e ditur". / "El Pais" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Zydrunas Urbonas, trajner i Sigal Prishtinës

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Trajneri i njohur lituanez dhe ish-lojtari i shumë ekipeve të njohura lituaneze, Zydrunas

Urbonas, i është bashkuar KB Sigal Prishtina. "Urbonas karrierën e trajnerit e ka nisur te skuadra e njohur Juventus

Utena ku nën drejtimin e tij për pesë vjet me radhë kanë arritur suksese të shkëlqyeshme si një nga

ekipet më të mira pas dy gjiganteve Zalgiris dhe Lietuvas Rytas", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.



# Malisheva nënshkruan me Fetahajn, përforcohen edhe Prishtina, Drita dhe Liria

Klubet e Superligës në futboll janë duke vazhduar ndryshimet në radhët e veta. Malisheva, pasi zgjodhi trajnerin e ri të premtën, është përforcuar me Liridon Fetahajn, një lojtar i dëshmuar në futbollin e Kosovës. Nga një transferim në 24 orët e fundit e kanë realizuar edhe Prishtina, Drita e Liria

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Futbollisti me një karrierë mjaft të pasur futbollistike, Liridon Fetahaj, është transferimi më i ri i skuadrës së Malishevës. Ish-futbollisti i Ballkanit ka qenë një nga lojtarët kryesor në rrugëtimin e Lirisë drejt rikthimit në Superligë, kurse pas përfundimit të kampionatit vendosi të ndahet me këtë skuadër. Ndërsa sot erdhi zyrtarizimi nga Malisheva për arritjen e marrëveshjes me futbollistin në fjalë. "Klubi njofton se ka kompletuar marrëveshjen për transferimin e Liridon Fetahajt nga Liria në Malishevë. Mirë se vjen, Liridon!", thuhet në njoftimin e Malishevës.

Fetahaj ka shprehur optimizëm se do të arrijnë sukses. "Shpresoj t'i arrijmë objektivat së bashku. Falënderoj presidentin Driton

Morina dhe stafin udhëheqës të Malishevës", ka thënë Fetahaj. Malisheva një ditë më parë e zyrtarizoi edhe trajnerin e ri, Senad Alirifa. Ky i fundit dy vjet më parë ishte larguar nga Malisheva, kur klubi bënte gara në Ligën e Parë, por tash drejtuesit e skuadrës kanë besuar në trajnerin Alirifa. Ndërsa skuadra e Dritës, që përfundoi në vendin e dytë në Superligë, është përforcuar me një sulmues. Fjala është për Blerim Krasniqin. "Blerim Krasniqi do të jetë pika referente e sulmit i cili vjen nga një përvojë e gjatë në Superligën shqiptare. Blerimi ka qenë pjesë edhe e Superligës së Kosovës dhe, së fundmi, ka qenë pjesë e ekipit CS Mioveni nga Superliga e Rumanisë. Lojtari është pritur në zyrat e klubit nga drejtori sportiv Valon Zymbëri dhe marrëveshja është nënshkruar për periudhën dyvjeçare", ka njoftuar klubi gjilanas. Mbrojtësi Melos Zenunaj është



futbollisti i ri i skuadrës së Lirisë nga Prizreni. Qendërmbrojtësi ishte pjesë e Dukagjinit të Klinës, derisa me prizrenasit ka nënshkruar kontratë dyvjeçare. "Pres të dëshmojmë dhe me klubin të arrijmë objektivat", ka thënë 22-vjeçari pas arritjes së

marrëveshjes me "bardhezinjtë". FC Prishtina e ka transferuar mbrojtësin e krahut, Ermal Veliqi, i cili në skuadrën kryeqytetase vjen nga KF Drenica. Futbollisti 21-vjeçar ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Prishtinën, ndërkohë që është

paraqitur në ambientet e klubit nga drejtori sportiv, Driton Krasniqi. "Prishtina është klub i madh dhe me shumë traditë. Gjithmonë kam pasur dëshirë të luaj për Prishtinën. Në këtë afat kalimtar kam pasur edhe shumë oferta të tjera, por atë të Prishtinës nuk mund ta refuzoja. Besoj se te Prishtina do të kaloj shumë mirë. Ambienti duket pozitiv. Synimet janë të fitojmë trofe", ka thënë Veliqi.

## Nderim Nexhipi largohet nga Ballkani

Nderim Nexhipi është larguar nga detyra e drejtorit sportiv në skuadrën e Ballkanit. Kampionët e Kosovës kanë njoftuar se Nexhipi është larguar nga skuadra për arsyeje familjare. "Në koordinim të dyanshëm, klubi e ka pranuar kërkesën e drejtorit sportiv, Nderim Nexhipi që, për shkaqe familjare, nuk mund ta vazhdojë qëndrimin e mëtutjeshëm në Kosovë. Duke e falënderuar për kontributin e çmuar në rrugëtimet tona të suksesshme, për të FC Ballkani gjithmonë do të mbetet një shtëpi e hapur", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

## Donjeta Sadiku dhe Shpëtim Bajoku e nisin me këmbë të mbarë në Lojërat Evropiane


PRISHTINË, 23 QERSHOR - Donjeta Sadiku e ka nisur në mënyrën më të mirë garimin në Lojërat Evropiane "Krakoë 2023". Boksierja e Kosovës shënoi fitore ndaj Shona Whitwell të Britanisë së Madhe, me vendim unanimit të gjyqtarëve. Sadiku dominoi në të tria raundet, që u vlerësua edhe nga gjyqtarët. Donjeta u kualifikua në 1/16 e finale, për çka i



duhen edhe dy fitore për ta siguruar medaljen dhe normën olimpikë "Paris 2024". Shpëtim Bajoku e ka nisur mbarë garimin në Lojërat Evropiane "Krakow 2023". Boksieri kosovar mundi kroatian Matea Komadina, 4:1 me pikë, kategoria -63.5 kg. Bajoku u kualifikua në mesin e 16 boksierëve më të mirë dhe për ta siguruar medaljen i duhen edhe dy fitore.

## Begolli emërohet trajner i FC Suhareka

SUHAREKË, 23 QERSHOR - Granit Begolli është emëruar kryetrajner i skuadrës së Suharekës në Ligën e Parë të Futbollit të Kosovës. Lajmin e ka konfirmuar klubi i Suharekës nëpërmjet faqes zyrtare në rrjetet sociale. Begolli së fundmi ishte trajner i Feronikelit '74, skuadër e cila siguroi inkuadrimin në Superligën e Kosovës. "Kryetrajneri i ri skuadrës sonë do të jetë Granit Begolli, timonieri kampion që me sukseset e tij është shquar vitet e fundit në futbollin e Kosovës, ka arritur marrëveshje duke i besuar projektit tonë drejt inkuadrimit në Superligën e Kosovës.



Begolli si futbollist me bagazh të madh, por edhe si trajner, duke drejtuar skuadra si KF Vëllaznimi, KF Liria dhe, së fundmi, kampion me KF Feronikeli '74, duke i inkuadruar në elitën e futbollit të Kosovës, një punëtor i jashtëzakonshëm me disiplinë të shquar dhe një drejtues teknik i fuqishëm. Ditët në vijim do të kompletohet edhe i gjithë stafi punues që, së bashku me Granitin, do të fillojnë punën me një skuadër të kompletuar. Prezantimi i tij nën emblemën e FC Suhareka do të bëhet ditëve në vijim", thuhet në njoftimin e FC Suhareka.

## Astrit Fazliu përforcon Vjosën

Shtime, 23 qershor - Një prej lojtarëve më të trofeshëm në Kosovë, Astrit Fazliu, është përforcimi më i ri i skuadrës së Vjosës. Klubi nga Liga e Parë e ka paraqitur ish-sulmuesin e Dritës,

Prishtinës dhe shumë klubeve të tjera. Astrit Fazliu edicionin e fundit ishte pjesë e Ferizajt në Superligën e Kosovës. "Astrit Fazliu është përforcimi i madh i KF Vjosa. Astriti është ndër

lojtarët më të trofeshëm në Kosovë, pesë herë kampion i Kosovës, tri herë fitues i Kupës. Me Astritin i shtojmë kualitetet dhe shumë përvojë ekipit tonë. Mirë se vjen Astrit në qytetin e

Shtimes dhe në KF Vjosa", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vjosës. Fazliu, përveç Kosovës, ka karrierë edhe në Partizanin dhe Flamurtarin e Shqipërisë dhe FC Shkëndija Tetovë.



## Blerand Stavileci zgjedhet kryetar i KB Sigal Prishtina

Prishtinë, 23 qershor - KB Sigal Prishtina e ka mbajtur Kuvendin e Punës dhe Zgjedhor. Blerand Stavileci unanimisht është zgjedhur kryetar i KB Sigal Prishtina me mandat të plotë. "Blerandi është ish-lojtar, kapiten dhe

drejtor i klubit. Klubi ynë i ka arritur sukseset më të mëdha gjatë periudhës sa ai ishte kryetar. Nga të gjitha klubet e Kosovës është i vetmi që ka trofe të fituar edhe si kryetar, edhe si drejtor edhe si lojtar", thuhet në njoftimin e

Prishtinës. Në ambientet e "Hotel Garden", me 34 anëtarë të pranishëm, ku ndër ta ishin përfaqësues të "Plisave", të sponsorëve besnikë të klubit, menaxhmenti, si dhe të shumë kontribuuesve e dashamirëve të klubit më të

profeshëm, u diskutua për raportin e punës, raportin financiar, auditimin për vitin 2022 dhe për synimet për sezonin e ardhshëm. Po ashtu, u zgjodh bordi i ri drejtues i klubit, me 12 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi.



## De Biasi beson te kualifikimi: Nuk kam zili për Sylvinhon

Tiranë, 23 qershor - Dy fitoret kundër Moldavisë dhe Ishujve Faroe, vendi i dytë në grup dhe kriza e Polonisë kanë ndezur ëndrrën e Shqipërisë për të shkuar sërish në Evropian. Rruga është ende e gjatë, por jo e panjohur. Shtatë vjet më parë, me Gianni De Biasin në krye, kuqezinjtë ia dolën ta shkruanin historinë. Tani ndoshta edhe nga dëshira e madhe për të qenë sërish në një kompeticion kaq të rëndësishëm, kanë nisur t'i kërkojnë Silvinjos atë që bëri De Biasi: kualifikimin në "Euro 2024". A janë shanset për ta bërë këtë? De Biasi thotë "po". Për "Panorama Sport", italiani thotë se Shqipëria i ka kartat në rregull, që jo vetëm të kualifikohet, por edhe ta zërë vendin e parë në grup. "Ja thashë Dukës që kur ishim bashkë në hedhjen e shortit në Frankfurt se patën fat. Natyrisht, nuk prisja që Polonia të pengojë kaq herët, por ama i thashë se me këtë grup mund të



dilni të parët ose të dytët", është batuta e De Biasit që në fillim. Ish-trajneri i kuqezinjve, De Biasi, ka thënë se e ka përcjellë Shqipërinë në ndeshjen e fundit kualifikuese për "Euro 2024". "Kam parë një pjesë të madhe të ndeshjes kundër Moldavisë. Ndaj Ishujve Faroe nuk e ndoqa dot direkt, por pashë disa pjesë dhe natyrisht golat", ka thënë ai. I pyetur se si vlerëson ecurinë e

Kombëtares shqiptare, De Biasi është përgjigjur: "E pritshme. Brenda normales. Shqipëria ka një grup të mirë, mendoj më të favorshëm se ai në 2016, por ndërkohë ka edhe një grup lojtarësh cilësorë që mund ta bëjnë surprizën". Strategu italian ka thënë se kuqezinjtë mund të kenë rezultate befasuese. "Që mund të renditet edhe e para në grup", ka përfunduar De Biasi.

## Komiteti Olimpik Ndërkombëtar përjashton sportin e boksit nga Olimpiada

Paris, 23 qershor - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) ka përjashtuar nga ngjarjet olimprike sportin e boksit amator. Ky vendim ishte i pritshëm pas konfliktit që IOC kishte prej vitësh me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (IBA). Vendimi do të hyjë në fuqi në Olimpiadën e vitit 2028, në Los Anxhelos, ndërkohë që boksi do të jetë i pranishëm në "Paris 2024". Në një asamble të jashtëzakonshme, 69 anëtarë të IOC votuan pro përjashtimit të boksit dhe vetëm një 1 votë ishte kundër. Kjo federatë ishte pezulluar nga IOC prej vitit 2019 për shkak të akuzave për korrupsion, problemeve me lidërshpin dhe manipulim të rezultateve. Për këtë arsye ishte Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ai që i organizoi eventet



qualifikuese të Tokio 2020. Edhe në Olimpiadën e Parisit do të jetë IOC ai që do të merret me menaxhimin e eventeve kualifikuese të boksit. Ndërkohë që, një federatë rivale mund të zërë vendin e IBA në familjen olimprike. IBA u përpoq në këto muaj të mos lejonte

përjashtimin e sportit të boksit nga Olimpiadat, por nuk e fitoi dot betejën me IOC. Ai kishte rekomanduar përjashtimin, bazuar në një raport që kishte publikuar në fillim të qershorit. Edhe CAS i Lozanës hodhi poshtë pretendimet e IBA-s.

### SHKURT

#### Berisha, afër transferimit në Turqi

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, pritet të largohet pas shumë vitesh nga futboli italian dhe të transferohet në Turqi. Berisha pati mjaft probleme në skuadrën e Torinos për shkak të mos pajtimeve me trajnerin Ivan Juriç. Siç raportojnë mediet turke, skuadra e Fatih Karagumruk ka shprehur interesim për portierin nga Kosova, i cili është gati të provojë një përvojë të re. 34-vjeçari ka luajtur edhe për Atalantën, Lazion, Spalin dhe Kalmarin në Suedi.

#### Guerreiro, lojtar i ri i Bayernit

Raphael Guerreiro edhe zyrtarisht është lojtar i Bayern Munchenit. Anësori pas 7 vjetësh në Borussia Dortmund largohet si lojtar i lirë, kurse me kampionët e Gjermanisë ka nënshkruar deri në vitin 2026. Portugezi me "verdhezinjtë" e Dortmundit arriti të fitonte dy herë Kupën e Gjermanisë, në vitet 2016-2017 dhe 2020-2021, si dhe ka fituar gjithashtu Superkupën e Gjermanisë.

#### Unitedi ofron 65 milionë paund për Mountin

Manchester Unitedi ka shfaqur interesimin për yllin e Chelseat, Mason Mount tash e një kohë të gjatë. Gazetari sportiv Fabrizio Romano mund të mbyllet brenda javës së ardhshme. Për sa i përket çmimit, skuadra e Erik ten Hag beson se një shifër midis 60-65 milionë paund është e mjaftueshme për t'i bindur "blutë" e për sa i përket lojtarit çdo detaj është marrë disa ditë më parë e tanimë pritet vetëm firma mes klubeve.

#### Lukaku refuzon 100 milionë euro për Interin

Romelu Lukaku dëshiron vetëm Interin për të ardhmen. Sulmuesi belg ka refuzuar një tjetër ofertë nga Arabia Saudite, me një klub që këtë herë i ka ofruar 100 milionë euro për tre sezone. Gjithsesi Lukaku është ende i bindur se ka shumë për të dhënë në futbollin evropian dhe konkretisht me fanellën e Interit, klub ku ka treguar edhe cilësitë e tij më të mira. Dëshirën e tij për t'u rikthyer tek Interi edhe për sezonin e ri, Lukaku ua ka bërë të qartë drejtuesve të Chelseat, të cilët pritet të miratojnë një tjetër huazim njëvjeçar të tij. Lukaku e ka konfirmuar vazhdimisht afekcionin e tij për fanellën zikaltër dhe kërkon të marrë një rol të rëndësishëm në projektin e klubit, teksa në ditët e ardhshme Ausilio pritet të zbarkojë sërish në Londër për të folur me drejtuesit e Chelseat.

## Arabia Saudite nuk do të kandidojë për Botërorin 2030

Arabia Saudite tërheq kandidaturën për organizimin e Kupës së Botës 2030. Është gazeta "Marca" që shkruan se vendimi është

marrë në bazë të fuqisë së projektit të Spanjës, Portugalisë dhe Marokut. Pasi kanë analizuar tablonë e situatës, auditët kanë arritur

në përfundimin se është e pamundur ta mbizotërojnë kandidaturën rivale, e përforcuar nga puna diplomatike e federatave

portugeze dhe spanjolle në vitet e fundit. Ministri i Jashtëm saudit ka kontaktuar në këto orë Greqinë dhe Egjiptin për ta komunikuar

braktisjen e projektit. Ndërkohë nuk është bërë me dije nëse Arabia Saudite do të konkurrojë për Botërorin 2034.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ajshe Thasqi nga Damajani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. Pjeter Bogdani Damjan nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Edona Ermeni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- "Asosacioni Alter" shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr. 602772445.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- "Haja" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810191643.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Saranda Marashi nga Ramoci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Luigj Gurakuqi" Korenic KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lulzim Avdiu, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani"

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Vehbi Ahmeti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda"

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Fitore Xhemajli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Hysen Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfm u "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Artiola Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfm u "Fadil Hisari" Prizren.

- Florjan Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Nahit Shala nga Rogova e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi -Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

